

## DETYRAT DHE KOMPETENCAT

Në zbatim të Ligjit 8652 datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 44, Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet urdhërave dhe vendimeve, organizon dhe drejton punën e administratës për kryerjen e funksioneve të Bashkisë. Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë:

- a)** Ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetencë vetëm e këshillit Bashkiak;
- b)** Zbaton aktet e këshillit Bashkiak;
- c)** Merr masa për përgatitjen e materialeve të mbledhjeve për këshillin bashkiak, në përputhje me rendin e ditës të përcaktuar nga këshilli, si dhe për probleme që kërkon ai vetë;
- ç)** Raporton në këshill për gjendjen ekonomiko-financiare të paktën çdo 6 muaj ose më shpesh, sa herë kërkohet nga këshilli;
- d)** Raporton para këshillit sa herë kërkohet prej tij për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e bashkisë;
- dh)** Është anëtar i këshillit të qarkut;
- e)** Emëron dhe shkarkon N/kryetarët e bashkisë, Drejtorin e kabinetit;
- ë)** Emëron dhe shkarkon drejtuesit e ndërmarrjeve dhe institucioneve në varësi;
- f)** Emëron dhe shkarkon punonjësit e tjerë jodrejtues të strukturave dhe njësive në varësi të komunës ose bashkisë, përveç kur parashikohet ndryshe në ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”;
- g)** Ushtron të drejtat dhe siguron plotësimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik;
- gj)** Merr masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive;
- h)** Kthen për rishqyrtim jo më shumë se një herë në këshill vendime, kur vëren se ato çënojnë interesa të bashkësisë.